



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

PML.nr.18/2024

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Agim Maliqi kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Rasim Rasimi anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini-Siminica, në çështjen penale kundër të pandehurit R. L., për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë, nga neni 315, paragrafi 2., pika 2.1., e lidhur me paragrafin 1., pika 1.1. dhe neni 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, PPR.nr.104/2023 të datës 20.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 09.01.2024, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

I. Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit R. L., anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, PPR.nr.104/2023 të datës 20.12.2023 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

II. I pandehuri duhet të qëndrojë në paraburgim deri në marrjen e një vendimi të ri.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, me aktvendimin PPR.nr.104/2023 të datës 20.12.2023, të pandehurve R. L. dhe M. M., për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë, nga neni 315, paragrafi 2., pika 2.1., e lidhur me paragrafin 1., pika 1.1. dhe neni 31 të KPRK-së, iu ka vazhduar masën e paraburgimit për 1 (një) muaj e cila do t'i zgjas deri me 22.01.2024. Masa e paraburgimit është vazhduar në bazë të nenit 184 paragrafi 1., nën-paragrafi 1.1. dhe 1.2., pikat 1.2.2. dhe 1.2.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Kundër këtij aktvendimi, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit R. L., avokat I. Z., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovoj

kërkesën dhe të ndryshojë aktvendimin e atakuar, ashtu që të pandehurin ta liroj nga paraburgimi që të mbrohet në liri ose t'ia caktojë një masë tjetër alternative për sigurimin e të pandehurit në procedurë.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.11/2024 të datës 05.01.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesës, dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të pandehurit thekson se gjykata e shkallës së parë si dhe gjykata e shkallës së dytë nuk kanë dhënë arsye të mjaftueshme për vazhdimin e masës së paraburgimit, ngase nuk kanë përmendur asnjë provë të vetme se i njëjti ka qenë i përfshirë në kryerjen e veprës penale për të cilën dyshohet, se nuk ekziston rreziku i ndikimit në bashkëkryerësit apo në dëshmitarë sepse asnjërin nuk e njeh dhe nuk ka pasur ndonjë raport apo lidhje me ata, ndërsa sa i përket rrezikut të përsëritjes së veprës penale gjykata në mënyrë tërësisht të paargumentuar ka konstatuar se ekziston një bazë e tillë duke u thirrur në peshën e veprës penale, deri sa neni 172 paragrafi 2. i KPP-së ka përcaktuar se gjykata detyrohet t'i marr parasysh kushtet e përcaktuara për masat konkrete dhe të sigurojë që të mos caktohet masa më e rëndë kur mjafton masa më e butë.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se janë të bazuara pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit se aktvendimi i kundërshtuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë përshkrimin e provave, respektivisht nuk ka dhënë arsye dhe nuk i ka specifikuar rrethanat dhe provat konkrete për rrezikun e ndikimit si dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale, konform nenit 184 paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2., pikat 1.2.2. dhe 1.2.3. të KPP-së, për të cilat baza është vazhduar paraburgimi.

Në aktvendimin e atakuar vetëm është parafrazuar dispozita ligjore e nenit 184 të KPP-së, lidhur me kushtet e nevojshme për vazhdimin e paraburgimit pa i specifikuar ato më detalisht dhe më konkretisht, të cilat fakte do të arsyetonin dhe mbështesin ekzistimin e rrezikut “...të fshehjes apo asgjësimit të provave të veprës penale si dhe ndikimit në dëshmitarë, në të dëmtuarit apo bashkëpjesëmarrës tjerë”, nuk përmbajnë sqarim se cilët janë dëshmitarët të cilët pretendohet se do të dëgjohen, cilët bashkëpjesëmarrës tjerë, a janë në arrati dhe ku qëndron lidhja e tyre, i njëjtit si do të mund të ndikojë tek ata. E po ashtu edhe rreziku i përsëritjes së veprës penale nuk është specifikuar ku në aktvendimin e atakuar thuhet se “duke pasur parasysh peshën e veprës penale, mënyrën dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale...” duke mos cekur ndonjë rrethanë konkrete e cila arsyeton këtë bazë, ndërsa rreziku i përsëritjes së veprës penale duhet të dëshmohet me fakte konkrete duke i specifikuar si: personaliteti i të pandehurit, sjellja e tij në të kaluarën e në veçanti nëse ka ndonjë dënim të mëhershëm për vepër të ngjashme penale.

Në bazë të nenit 188, paragrafi 1. të KPP-së, kur kërkohet vazhdimi i paraburgimit, në bazë të kërkesës së prokurorit të shtetit, i cili tregon se ka bazë për vazhdimin e paraburgimit nga neni

184 të KPP-së, duhet patjetër të jap edhe arsyetimin se pse ende nuk i ka ndërmarrë të gjitha veprimet e arsyeshme për të përshpejtuar procesin e hetimit, përkatësisht pse ende nuk janë dëgjuar të dëmtuarit, si dhe pse ende nuk janë dëgjuar as dëshmitarët e rastit, që do të verifikohen përmes video incizimeve.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e rivendosjes duhet t'i evitohet shkeljet e theksuara më lartë dhe në arsyetim duhet të përmbajë arsye konkrete, përshkrimin e provave specifike që e mbështesin rrezikun e ndikimit si dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale. Nuk është i mjaftueshëm vetëm përshkrimi i dispozitës ligjore pa i elaboruar edhe provat dhe arsye konkrete dhe specifike që e mbështesin rrezikun e tillë për të pandehurit konkret.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 438 par.1 nën par.1.2 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
Pml.nr.18/2024 datë 09.01.2024.

Bashkëpunëtorja profesionale  
Mirlinda Mejzini-Simnica

Kryetar i kolegjit,  
Agim Maliqi